

AKT THEMELIMI I SHOQËRISË
“FDE & PARTNERS LTD” sh.p.k

Ne mbështetje të Ligjit Nr.9901, datë 14.4.2008 “*Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare*”, vendosa hartimin e këtij Akti Themelimi, me kushtet që përcaktohen si më poshtë:

Sot ne date 13.09.2024, ortaket e shoqerise:

- z. Fatos Dani** i datëlindjes 12.09.1972 shtetas Shqipetar, lindur në Vlore, mbajtës i dokumentit Pashaporte me Nr. H20912081W.
- z. Dragan Protic** i datelindjes 17.11.1958 shtetas Italian, lindur në Beograd (Serbi), mbajtës i dokumentit pashaporte nr. YC2706832.
- z. Edvin Lico** i datelindjes 10.02.1980 shtetas Shqipetar, lindur në Tirane, mbajtës i dokumentit leternjoftim nr. I00210051P.

me vullnetin e saj te lire dhe te plote, te shprehur nepermjet ketij akti themelimi, vendosi per krijimin e shoqerise tregetare **“FDE & PARTNERS LTD”** Shpk me kushtet e meposhteme:

Neni 1
EMERTIMI

Shoqeria Tregtare do te ketë Emërtimin **“FDE & PARTNERS LTD”** Shpk.

Neni 2
FORMA JURIDIKE

Shoqëria Tregtare **“FDE & PARTNERS LTD”** Shpk, themelohet si Shoqëri Tregtare me Përgjegjësi të Kufizuar sh.p.k. Shoqëria është Person Juridik Privat Shqipëtar. Shoqëria kriohet në bazë të Ligjit nr.9901, datë 14.4.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, ku ne nenin 3 percaktohet se:

- ”1. Shoqëritë tregtare themelohen nga dy ose më shumë persona fizikë dhe/ose juridikë, që bien dakord për arritjen e objektivave ekonomikë të përbashkët, duke dhënë kontribute në shoqëri, sipas përcaktimeve në statutin e saj. Shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar dhe shoqëritë aksionare mund të themelohen edhe vetëm nga një person fizik dhe/ose juridik (shoqëritë me ortak apo aksionar të vetëm).**
- 2. Shoqëritë tregtare duhet të regjistrohen sipas nenit 22 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, si dhe neneve në vijim, sipas formës përkatëse të shoqërisë tregtare.**
- 3. Shoqëritë tregtare fitojnë personalitetin juridik në datën kur kryhet regjistrimi i tyre në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit. Shoqëritë përgjigjen me të gjitha aktivet e tyre për detyrimet, që rrjedhin nga veprimtaritë e ushtruara.”**

Neni 3
KOHEZGJATJA

Kohëzgjatja e shoqërisë **“FDE & PARTNERS LTD”** Sh.p.k do te vazhdoje veprimtarine e saj me një afat kohor te pakufizuar.

Shperndarja ose prishja e shoqerise mund të behet ne cdo kohe :

- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
- b) me vendim të ortakevë te shoqerise;
- c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
- ç) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare përdy vjet dhe nuk është njofuar pezullimi i veprimitarisë në përpunje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”;
- d) me vendim të gjykatës;

Ne kete rast Ortaket e shoqerise marrin vendim me shkrim ne të cilin parashikojne menyren e likuidimit të shoqerise, duke caktuar 1 apo disa likuidatore dhe shenuar ne cdo dokument të nxjerre prej tij emrin e likuidatorit

dhe emertesen shtese " Shoqeri ne likuidim e siper ".

Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi.

Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga Ortaket e shoqerise.

Nëse Ortaket e shoqerise nuk marrin një vendim përemërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjakatës, për të caktuar një likuidues.

Neni 4

SELIA

Shoqëria Tregtare "**FDE & PARTNERS LTD**" Sh.p.k e ka selinë ne qytetin e Vlore, : Lagjja Pavaresia, Rruga Cajupi,Pallati Gobus Konstruksion,Kati i pare, nr.10, Vlore Emali fdepartners@gmail.com
Tel : 0693414322.

Shoqeria mund te ndryshoje seline e saj, te hape zyra perfaqesie, dege, te krijoje filiale, si brenda ashtu edhe jashte Republikes se Shqiperise, vetëm me vendim te Ortakeve te Shoqerise.

Neni 5

OBJEKTI I VEPRIMTARISE SE SHOQERISE

Shoqeria ka si objekt te veprimitarise se saj:

-Tregtimi karburanteve te ndryshem me shumice, si vajrave lubrifikante, te gazit te lengshem per ngrohje, paisje ngrohese gazi etj.Pika karburantesh me pakice dhe servisi snak-bar , importimin shitjen e naftes dhe vajrave minerale te paperpunuar, transportimin dhe per llogari te te treteve, depozitim perzierjen, trajtimin, shitjen, shperndarjen me shumice te qymyrit, gazit, lubrifikanteve , produkteve te naftes dhe naftokimike, duke perfshire ketu edhe bitumet. Blerjen shitjen qeradhënien ndertimin dhe administrimin e impianteve, depozitave dhe administrimin e ndertesave dhe pasurive te veta te paluajteshme. Eksport i naftes dhe vajrave minerale te paperpunuara,qymyrit,gazit,lubrifikanteve,produkteve te naftes dhe naftokimike,duke perfshire ketu dhe bitumet.Furnizimin e mjeteve detare me Hidrokarbure ne Porte. Import - eksport, tregetimi te hidrokarbureve, lendeve djegese te llojeve te ndryshme dhe nenprodukteve te tyre me shumice e pakice. Sherbim konsulencje juridike, financiare,ekonomike,administrim projekteve,kontrataste,perfaqesim i te treteve, studime ekonomike, juridike,sociale,si dhe ofrim konsulence per te rejat e fundit te shkences dhe teknologjise, pjesmarje ne tendera, gara, etj. Konsulence ne kerkim, prodhim,tregetim te energjise elektrike ,te gazit, te avullit, si dhe aktivitet ndermjetesimi, vlersimi, shiteblerje, qera, menaxhim te ndermarrjeve tregetare, kryerjes se kerkimeve dhe studimeve ne fushen imobilare, etj. Marrjen e kredive nga bankat e nivelit te detye si dhe ofrimin e garancive, hipotekave ne favor te ndonje banke apo instituti krediti. Shoqeria mund te zhvilloje keto sherbime si direkt ashtu dhe nepermjet konsulenteve apo te te treteve. Kryerjen e te gjithe operacioneve tregetare, industriale dhe financiare mbi pasuri te luajtshme apo te paluajtshme, te konsideruara te dobishme ose te nevojshme per arritjen e qellimit te aktivitetit, si dhe te atyre qellimeve qe lidhen direkt apo indirekt me te , perfshire, pjesmarjen ne shoqeri te tjera qe kane objekt te njeje ase te ngjashem dhe ne nje fare menyre te lidhur direkt apo indirekt me qellimin e shoqerise.Tregti automjeteve te ndryshem.motorcikletash,mjetesh lundruese,dheniem me qira te tyre.pjese kembimi per autovetura,motorcikletash dhe mjeteve lundruese,sherbime karoatreci,officine mekanike,lavazho automjetesh,elektroaut,impiante gazi pe autovetura,tregti me shumice dhe pakice i prodhimeve te agrikultures,cosmetike,ndertim ,sherbime restoranti, pizzerie,bari,hoteli,furre buke.mense.birrerie,diskoteke,tregti te ndryshme,import eksport,

Neni 6
KAPITALI THEMELTAR

Kapitali themeltari i shoqerise eshte i perbere nga kontributi i ortakeve themelues me vleren **100,000 lekë** dhe perbehet nga tre kuota:

- **Fatos Dani** eshte zoterues e 1 kuote me vlore 34,000 qe perben 34 % te kapitalit themeltar
- **Dragan Protic** eshte zoterues e 1 kuote me vlore 33,000 qe perben 33 % te kapitalit themeltar
- **Edvin Lico** eshte zoteruese e 1 kuote me vlore 33,000 qe perben 33 % te kapitalit themeltar

Neni 7
TRANSFERIMI I KUOTEVE

Kuotat e kapitalit jane lirisht te Transferueshme ndermjet Ortakeve. Ortaku qe kerkon te shese kuoten e tij nje personi te trete, duhet detyrimisht tu njoftoj ortakeve te shoqerise blerjen e kuotave te tij ne te njejtat kushte si personit te trete te cilit ai deshiron t'ia shese. Kur disa ortake ushtrojne te drejten e tyre te parablerjes dhe shprehin deshiren e tyre per te blere kuoten, ortaku shites gezon te drejten diskrecionale per te zgjedhur se cilit ortak ai deshiron ti shese totalisht ose pjeserisht kuotat e tij. Ortaket duhet te pergjigen brenda 30 diteve nese deshirojn te blejne kuotat e ofruara apo jo.

Neni 8

SHPERNDARJA E FITIMIT

Ortaket financojne, perfitojne rimbursim te financimit te tyre dhe ndajne fitimin e tyre ne baze te kuotave ne kapitalin themeltare.

Neni 9

ORGANET DREJTUESE TE SHOQERISE

Organet Drejtuese te Shoqerise janë:

1. Administratori,
2. Asamblea e Pergjithshme e Zakonshme ose e Jashtezakonshme e Ortakeve.
Aministrator i Shoqerise është Zj. Dritan Hysenj i datëlindjes 21/01/1980 shtetas Shqipetar, lindur në Vlore, mbajtës i dokumentit Pashaporte me Nr. I00121067H, me nje mandate 5 vjecar me të drejtë ripërtëritjeje.

Neni 10
KOMPETENCAT E ADMINISTRATORIT

Administrator ushtron kompetencia ne emer te Shoqerise:

- a) kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimitarisë tregtare të shoqerisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- b) përfaqësojë shoqerinë tregtare;
- c) kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqerisë;
- d) përgatis dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimitarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto



- dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
- e) krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
 - f) kryejë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënata detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
 - g) raportojë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare; Administratori eshte i detyruar të thërrasi mbledhjen e ortakut te vetem edhe ne rastet kur:
 - a) sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim dhe
 - b) kur shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara,
 - c) Administratori ka të drejte të kryeje të gjitha veprimet e administritimit të zakonshëm e të jashtëzakonshëm. Administratori përfaqëson Shoqërinë përpara të gjitha personave fizike e juridike, publike dhe/ose private vendas apo të huaj, autoritetet shtetërore Shqiptare apo të huaja, përfshi këtu autoritetet gjyqësore të gjitha shkalleve. Administratori ka të gjitha kompetencat për të vepruar në marrëdhënie me të tretët në emër të shoqërisë, në të gjitha rrethanat me përashtim të kompetencave që ligji ia jep shprehimisht ortakeve te shoqerise.
 - d) Administratori angazhon shoqërinë në marrëdhëni me të tretët nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e saj.

Neni 11

Veprimtaria ekonomike dhe financiare e shoqerise ndahet ne perjudha financiare 12 mujore. Viti finanziare fillon nga data 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor te cdo viti kalendarik, me perjashtim te vitit te pare i cili fillon nga data e krijimit te shoqerise dhe mbaron me 31 Dhjetor.

Neni 12

Shoqeria mban dokumentacionin e nevojshem financiar per administrimin e pasurise dhe per zhvillimin e te gjithe veprimtarise se saj, ne perputhje me kerkesat e te gjithe legjislacionit perkates ne fuqi.

Bilanci finanziar i shoqerise perpilohet ne baze te raportit me shkrime te eksperteve kontabel te autorizuar dhe te raportit te paraqitur nga administratoret brenda dates 31 mars te vitit pasardhes. Te dy raportet paraqiten me miratohen ne asamblene e ortakeve brenda dates 30 qershor.

Fitimi neto i shoqerise llogaritet mbasi zbriten humbjet e mundshme te vitit te meparshem, shlyerja e te gjitha detyrimet fiskale dhe ndaj cdo personi te trete, si dhe fondet financiare që perbejne rezerven e detyrueshem.

Neni 13

ZGJIDHJA E MOSMARREVESHJEVE

Mosmarrveshjet lidhur me themelimin dhe zhvillimin e veprimitarise se shoqerise zjidhen nga vete ortaket e shoqerise me mirekuptim, dhe kur kjo nuk arrihet ato zjidhen nga gjykata ne territorin e se ciles ndodhet selia e shoqerise.

Neni 14

Ky Akt Themelimi u hartua në 4 (katër) kopje originale
në gjuhën Shqipe.

**ORTAKET SHOQËRISË ‘FDE & PARTNERS
LTD Sh.P.K”**

Fatos Dani



Dragan Protic



Edvin Lico



STATUTI

I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

FDE & PARTNERS LTD

**KREU I
THEMELIMI, EMRI ,OBJEKTI,KOHËZGJATJA,SELIA.**

**NENI I
DATA E THEMELIMIT, THEMELUESIT DHE EMRI**

1 - Sot me datën 13.09.2024 une themeluesi kam kriuar një shoqëri me perjegjësi të kufizuar me emrin **FDE & PARTNERS LTD**.

- Themeluesi të shoqërisë janë :

z. Fatos Dani i datëlindjes 12.09.1972 shtetas Shqipetar, lindur në Vlore mbajtës i dokumentit Pashaporte me Nr. H20912081W .

z. Dragan Protic i datelindjes 17.11.1958 shtetas Italian, lindur në Beograd (Serbi) mbajtës i dokumentit pashaporte nr. YC2706832.

z. Edvin Lico i datelindjes 10.02.1980 shtetas Shqipetar, lindur në Vlore mbajtës i dokumentit leternjoftim nr. I00210051P.

**NENI 2
OBJEKTI I VEPRIMTARISË**

- Tregimi karburanteve te ndryshem me shumice, si vajrave lubrifikante, te gazit te lengshem per ngrohje, paisje ngrohese gazi etj.Pika karburantesh me pakice dhe servisi snak-bar , importimin shitjen e naftes dhe vajrave minerale te paperpunuar, transportimin dhe per llogari te te treteve, depozitim perzierjen, trajtimin, shitjen, shperndarjen me shumice te qymyrit, gazit, lubrifikanteve , produkteve te naftes dhe naftokimike, duke perfshire ketu edhe bitumet. Blerjen shitjen qeradhenien ndertimin dhe administrimin e impianteve, depozitave dhe administrimin e ndertesave dhe pasurive te veta te paluajteshme. Eksport i naftes dhe vajrave minerale te paperpunuara,qymyrit,gazit,lubrifikanteve,produkteve te naftes dhe naftokimike,duke perfshire ketu dhe bitumet.Furnizimin e mjeteve detare me Hidrokarbure ne Porte. Import - eksport, tregetimi te hidrokarbureve, lendeve djegese te llojeve te ndryshme dhe nenprodukteve te tyre me shumice e pakice. Sherbim konsulencje juridike, financiare,ekonomike,administrim projekteve,kontratash,perfaqesim i te treteve, studime ekonomike, juridike,sociale,si dhe ofrim konsulencje per te rejet e fundit te shkences dhe teknologjise, pjesmarrje ne tendera, gara, etj. Konsulencje ne kerkim, prodhim,tregetim te energjise elektrike ,te gazit, te avullit, si dhe aktivitet ndermjetesimi, vlersimi, shiteblerje, qera, menaxhim te ndermarrjeve tregetare, kryerjes se kerkimeve dhe studimeve ne fushen imobilare, etj. Marrjen e kredive nga bankat e nivelit te dyte si dhe ofrimin e garancive, hipotekave ne favor te ndonje banke apo instituti krediti. Shoqeria mund te zhvilloje keto sherbime si direkt ashtu dhe nepermjet konsulenteve apo te te treteve. Kryerjen e te gjithe operacioneve tregetare, industriale dhe financiare mbi pasuri te luajtshme apo te paluajtshme, te konsideruara te dobishme ose te nevojshme per arritjen e qellimit te aktivitetit, si dhe te atyre qellimeve qe lidhen direkt apo indirekt me te , perfshire, pjesmarrjen ne shoqeri te tjera qe kane objekt te njejtë ase te ngjashem dhe ne nje fare menyre te lidhur direkt apo indirekt me qellimin e shoqerise.Tregti automjeteve te ndryshem.motorcikletash,mjetesh lundruese,dheniem me qira te tyre.pjese kembimi per autovetura,motorcikletash dhe mjeteve lundruese,sherbime karoatreci,officine mekanike,lavazho automjetesh,elektroaut,impiante gazi pe autovetura,tregti me shumice dhe pakice i

prodhimeve te agrikultures,cosmetike,ndertim ,sherbime restoranti, pizzerie,bari,hoteli,furre buke.mense.birrerie,diskoteke,tregti te ndryshme,import eksport.

TË TJERA

(brenda kuadrit te dispozitave ligjore shoqeria ka të drejtë të shtojë aktivitetet e nevojshme në listë dhe të kryej çdo biznes të përshtatshëm për arrijen e qëllimit të saj)

NENI 3 KOHËZGJATJA

Kohëzgjatja e shoqerise **FDE & PARTNERS LTD.** është pa afat.

NENI 4 SELIA

Selia e Shoqerisë **“FDE & PARTNERS LTD.”** ndodhet në adresën si më poshtë Lagjja Pavaresia, Rruga Cajupi, Pallati Gobus Konstruksion,Kati i pare, nr.10

Emali fdepartners@gmail.com

Tel : 0693414322

NENI 5 EMRAT E REGJISTRUAR DHE EMËRTIMET TREGTARE

Shoqëria bazuar në Ligjin 9901datë 14.04.2008 "Per tregtarët dhe shoqëritë tregtare" (i ndryshuar) nen 4 , pika 2 etj ; do të përdorë dhë emërtime tregtare, si dhe shenja të tjera dalluese të veprimtarisë duke i regjistruar këto në përputhje me ligjin nr.9723, datë 3.5.2007 ‘Për Qendrën Kombëtare të Biznesit “ apo çdo ligj tjefér të posaçëm.

Kreu II KAPITALI

NENI 6 KAPITALI THEMELTAR

- Kapitali themeltar i shoqerise eshte i perbere nga kontributi i ortakeve themelues me vleren **100,000 lekë**.

Pjesmarja e themeluesve në kapitalin e shoqerise është në përputhje me kontributin e tyre finansiar si më poshtë:

-Ortakët themelues zoterojnë gjithsej 100% te kuotave dhe perbehet nga 3 (tre) kuota si me poshte:

- **Fatos Dani** eshte zoterues e 1 kuote me vlore 34,000 qe perben 34 % te kapitalit themeltar
- **Dragan Protic** eshte zoterues e 1 kuote me vlore 33,000 qe perben 33 % te kapitalit themeltar
- **Edvin Lico** eshte zoteruese e 1 kuote me vlore 33,000 qe perben 33 % te kapitalit themeltar

NENI 7

ZMADHIMI DHE ZVOGËLIMI I KAPITALIT THEMELTAR

Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet nëpërmjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, nepermjet emerimit nga gjykata kompetente e një eksperti te autorizuar per keto kontribute sipas kërkesës së administratorit.

Në asnjë rast shumica nuk mund të detyrojë një ortak për të rritur angazhimin e tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.

Zvogëlimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakëve, e cila merr vendim në të njëjtat kushte që kerkohen për ndryshimin e statutit.

Në të gjitha rastet zvogëlimi i prek ortakët në të njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqësojnë.

NENI 8 TRANSFERIMI I KAPITALIT

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve, për sa nuk parashikohet ndryshe ne statut.

Sanksionohet se, në rast të kalimit të kuotave me shitje apo dhurim të drejtën e parablerjes fillimisht e kanë ortakët ekzistues të shoqërisë.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

KREU III ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE

NENI 9 ORGANI VENDIMMARËS

Asambleja e Ortakëve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë.

Asambleja e Ortakeve është organi i vetëm vendimmarres i shoqerise që miraton cdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të percaktuara në ligj.

Asambleja e përgjithshme e ortakeve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqerinë për çështjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike;
- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshire përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- gi) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.

Administratori i shoqërisë nuk mund të veprojë si përfaqësues i ortakëve në asamblenë e përgjithshme. Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

NENI 10 MËNYRA E THIRRJES SË MBLEDHJES SË ASAMBLESË SË PËRGJITHSHME

Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë në adresën personale të deklaruar prej ortakut të cituar në statut dhe në rast ndryshimi të saj, në adresën e re të paraqitur pranë shoqërisë. Nnjëkohësisht do të kryhet dhe njoftimi nëpërmjet postës elektronike në adresën e sipërcituar dhe në rast ndryshimi të saj, në adresën e re të paraqitur pranë shoqërisë.

Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përparrë datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.

Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij nenit, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, përfundimisht.

NENI 11 KUORUMI

Në rastin e marjes së vendimeve të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse në të marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 70 përqind të kuotave.

Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar sipas nenit 87 të ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm, nëse ortakët që zotërojnë më shumë se me më shumë se të katërtat e numrit total të votave, janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të këtij ligji.

Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mblidhet përfundimisht, mungesës së kuorumi t'ë përmendur me lart, asambleja mblidhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

NENI 12 MARRJA E VENDIMEVE

Asambleja e përgjithshme vodos me më shumë se të katërtat të votave te zoteruesve te kapitalit, të ortakëve pjesëmarrës, përdryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Asambleja e përgjithshme vodos me mbi tre të katërtat e votave të ortakëve pjesëmarrës, për çështje të tjera si:

- a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
- b) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
- c) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- ç) përcaktimin e shpërblimeve
- d) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
- e) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- f) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;

Cdo ndryshim statuti duhet te depozitohet prane QKB per te pasqyruar ndryshimet ne skedën e shoqerisë.

NENI 13 PËRJASHTIMI NGA E DREJTA E VOTËS

1. Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse asambleja e përgjithshme merr vendim përfundimisht:

- a) vlerësimin e veprimtarisë së tij;
- b) shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij;
- c) ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria;
- ç) dhënen ose jo të përfitimeve të reja.

2. Kur ortaku përfaqësohet nga një përfaqësues i autorizuar, i autorizuari vlerësohet të jetë në të njëjtin konflikt interes, ashtu si dhe ortaku, të cilin përfaqëson.

NENI 14

ADMINISTRIMI

(1) Asambleja e përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë. Afati i emëritimit, eshte 5 vjet, me të drejtë ripërtëritjeje. Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

(2) Administratorët e një shoqërie tregtare mëmë, sipas përcaktimit të nenit 207 të këtij ligji, nuk mund të emërohen si administratorë të një shoqërie të kontrolluar e anasjelltas. Çdo emërim i bërë në kundërshtim me këto dispozita është i pavlefshëm.

(3) Administrator i shoqërisë caktohet Dritan Hysenj me një mandat 5-vjeçar nga data e regjistrimit të shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Bisnesit.

NENI 15

KOMPETENCAT E ADMINISTRATORIT

Administratorët ka të drejtë dhe detyrim të

- a) kryej të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- b) përfaqëson shoqërinë tregtare;
- c) kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- ç) përgatisi dhe nënshkruaj bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqet këto dokumente përparrë asamblesë së përgjithshme për miratim;
- d) krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrëthanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- dh) kryej regjistrimet dhe dërgojë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Biznesit;
- e) raportojë përparrë asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
- ë) kryej detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.

Administratori është i/e detyruar të thërrasi Asamblenë e Përgjithshme, në rastet kur:

- sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.
- shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.
- shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

Nëse asambleja e përgjithshme emëron më shumë se një administrator, ata e administrojnë bashkërisht shoqërinë. Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të cilësuar referuar nenit 12 të statutit.

Paditë, që lidhen me shpërbimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, irregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

NENI 16




PËRGJEGJËSITË E ADMINISTRATORIT

Administratori eshte përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara nga asambleja që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse.

Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit "Per Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", administratori detyrohet:

1. a) të kryejë detyrat e tij te përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërsi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjesid;
- b) të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;

- c) të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;
- ç) të parandalojë dhe mënjanjojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personalë me ata të shoqërisë;
- d) të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.
2. Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjen ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.
3. Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standarde profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, eshte i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkua. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidare.

4. Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratori eshte i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregëtare", kryen veprimet e mëposhtme:

- a) u kthen ortakëve kontributet;
- b) u paguan ortakëve interesa apo dividendë;
- c) u shpérndan aktivet shoqërisë;
- ç) lejon që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet;
- d) jep kredi.

Paditësit kanë të drejtë të ndjekin në rrugë ligjore shlyerjen e plotë të dëmit që i është shkaktuar shoqërisë, përfshirë edhe dëmshpërbimin financiar, nëse është e nevojshme. Asnjë vendim i asamblesë nuk mund të ndalojë ngritjen e kërkesë padisë kundër administratorit gjatë ushtrimit të detyrës.

KREU IV VITI FINANCIAR-EKSPERTËT

NENI 17

VITI FINANCIAR

Viti finanziar i Shoqerise fillon më 1 Janar dhe përfundon më 31 Dhjetor. Përashtimisht, viti i parë finanziar fillon nga data e regjistrimit të shoqerisë në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe mbylljet më 31 Dhjetor.

**NENI 18
EKSPERTËT**

-Eksperti referuar kërkesave të legjisacionit në fuqi ka për detyrë që të kontrolloj të gjithe dokumentacionin kontabël të veprimtarise ekonomiko tregtare të shoqerise, atë gjithëvjetor dhe atë ne lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij për rastet kur ai është ngarkuar dhe ka kryer një gjë të tillë i ngarkuar nga ana e ortakëve.

-Ne perfundim të kontrollit eksperti kontabël i autorizuar përgatit raportin me shkrim për rezultatin e bilancit finanziar vjetor si dhe për atë për kontrollet periodike të ushtruara, të cilat eshte i detyruar që t'ja paraqesë e dorezojë në kohë ortakëve për t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazën e të drejtës vendimore që ka.

**KREU V
PRISHJA -RIORGANIZIMI I SHOQËRISË
NENI 19**

PRISHJA DHE LIKUIDIMI

Shperndarja ose prishja e shoqerise mund të behet ne cdo kohe :

- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
- b) me vendim të Asamblese se Ortakëve;
- c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
- ç) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Biznesit";
- d) me vendim të gjykatës;

Ne kete rast Ortaket merrin vendim me shkrim ne të cilin parashikojne menyren e likuidimit të shoqerise, duke caktuar 1(një) apo disa likuidatore dhe shënuar në cdo dokument të nxjerrë prej tij emrin e likuidatorit dhe emërtesën shtesë " Shoqëri në likuidim e sipër ".

Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përashtim të rasteve kur ështënisur një procedurë falimentimi.

Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga Ortaket.

Nëse Ortaket nuk marrin një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.

**NENI 20
RIORGANIZMI I SHOQËRISË BASHKIMI-NDARJA**

Shoqëria mund të ndahet, bashkohet sipas Vendim të Mbledhjes së Përgjithshme të Asamblesë së Ortakëve, në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në Pjesën IX të Ligjit 9901 datë 14.04.2012 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare."

**NENI 21
BAZA LIGJORE**

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e tij në përputhje të plotë me këtë statut dhe dispozitat e legjisacionit shqiptar.

Për sa nuk parashikohet në këtë statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Per tregtarët dhe shoqëritë tregtare", Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjeter specifik në Republikën e Shqipërisë.

**NENI 22
MOSMARRËVESHJET**

Për mosmarrëveshjet që mund të lindin ne lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe për çdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis Shoqërisë dhe të tretëve, kompetente do të jetë Gjykata Shqiptare.

O R T A K U
I SHOQËRISE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

*** FDE & PARTNERS LTD * SH.P.K.**

Fatos Dani

1.



Emër mbiemër
(nënshkrimi)

Dragan Protic

2.



Emër mbiemër
(nënshkrimi)

3.

Edvin Lico



(nënshkrimi)